



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 23

Tiranë – E mërkurë, 17 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 3/2016 datë 28.1.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin” 2215
Ligj nr. 4/2016 datë 28.1.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave e Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në lidhje me lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit, BERZH - Shqipëri, llogari bashkëpunimi..... 2238
Ligj nr. 6/2016 datë 4.2.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe statutit të tij..... 2230



LIGJ
Nr. 3/2016

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN
“OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE ME
NË QENDËR QYTETARIN”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.1.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9418, datë 9.2.2016
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Departamenti ligjor
Drafti përfundimtar konfidencial
I negociuar
(I ndryshueshëm)
Nightingale Rukuba-Ngaiza

HUAJA NUMËR 8521-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(PROJEKTI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE ME QENDËR QYTETARIN)
NDËRMJET TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM E DATËS
23 SHTATOR 2015

NUMRI I HUAS 8521-AL

Marrëveshje e datës 23 shtator 2015, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Nëpërmjet saj, Huamarrësi dhe Banka bien dakord për sa më poshtë:

Neni I

Kushte të përgjithshme: Përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohen në bashkëlidhjen e kësaj Marrëveshjeje) janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë në Kushtet e Përgjithshme ose në bashkëlidhjen e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit, sipas afateve kohore dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, shumën prej njëzet e nëntë milionë e treqind mijë eurosh (29.300.000 euro) (Huaja), ose shumën e saj të barasvlershme pas konvertimit të saj, sipas kursit të këmbimit, në përputhje me dispozitat e seksionit 2.08 të kësaj Marrëveshjeje (Huaja), për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat e Huas në përputhje me seksionin IV të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë kërkesën se nuk do të kryhet asnjë tërheqje Huaje për pagesa për të financuar Programe Shpenzimesh të Pranuar sipas Kategorisë 1, përveç rasteve kur janë arritur kushtet përkatëse dhe rezultatet e çdo treguesi përkatës të lidhur me disbursimin - DLI, siç parashikohet në aneksin 2 të shtojcës 2.

2.03 Pagesa fillestare, e pagueshme nga Huamarrësi, është e barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2.04 Tarifa e Angazhimit, e pagueshme nga Huamarrësi është e barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit mbi tepricën e tërhequr të Huas.

2.05 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo periudhë interesi do të jetë në një normë të barabartë me normën e referencës për monedhën



e Huas, plus shtrirjen fikse; me kusht që me konvertimin e të gjithë ose të një pjese të principalit të Huas, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi gjatë periudhës së konvertimit mbi një shumë të tillë, përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit IV të Kushteve të Përgjithshme. Pavarësisht sa më sipër, në rast se një sasi e teprcës së tërhequr kreditorë mbetet e papaguar në kohë, dhe kur vazhdon të mos paguhet për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi do të llogaritet siç parashikohet në seksionin 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.06 Datat e pagesave janë 15 janar dhe 15 korrik të çdo viti.

2.07 Principali i Huas shlyhet në përputhje me grafikun e amortizimit të parashikuar në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.08 a) Huamarrësi mundet që në çdo kohë të kërkojë ndryshimet e mëposhtme të kushteve të Huas, me qëllim që të mundësojë menaxhimin e kujdesshëm të borxhit: i) ndryshimin e monedhës së Huas të të gjithë ose të një pjese të principalit të Huas, të tërhequr apo të patërhequr, në një monedhë të miratuar; ii) ndryshimin e bazës së normës së interesit të zbatueshëm, për: A) të gjithë ose një pjesë të principalit të Huas së tërhequr apo të mbetur, nga një normë e ndryshueshme në një normë të pandryshueshme, ose e kundërta; ose B) të gjithë ose një pjesë të principalit të Huas së tërhequr dhe të mbetur, nga një normë e ndryshueshme, bazuar në një normë reference, dhe nga një shtrirje e ndryshueshme në një normë të ndryshueshme, bazuar në një normë reference fikse dhe shtrirje të ndryshueshme, ose e kundërta; ose C) të gjithë sasinë e principalit të Huas së tërhequr dhe të mbetur nga një normë e ndryshueshme, bazuar në një shtrirje të ndryshueshme, në një normë të ndryshueshme bazuar në një shtrirje fikse; dhe iii) përcaktimin e kufijve për normën e ndryshueshme ose normën e referencës, të zbatueshme për të gjithë ose një pjesë të principalit të Huas së tërhequr dhe të mbetur nga vendosja e një Tavani të normës së interesit ose një dyshemeje të normës së interesit mbi normën e ndryshueshme ose mbi normën e referencës.

b) Çdo konvertim i kërkuar në përputhje me shkronjën “a” të këtij seksioni që pranohet nga Banka konsiderohet “Konvertim”, siç

përkufizohet në Kushtet e Përgjithshme, dhe do të realizohet në përputhje me dispozitat e nenit IV të Kushteve të Përgjithshme dhe Udhëzimet e Konvertimit.

c) Menjëherë pas datës së ekzekutimit të tavanit të normës së interesit ose nivelit më të ulët të normës së interesit për të cilën Huamarrësi ka kërkuar që primi të paguhet nga të ardhurat e Huas, Banka, në emër të Huamarrësit, tërheq nga Llogaria e Huas dhe paguan për vete shumat e kërkuara për pagimin e çdo primi të pagueshëm në përputhje me seksionin 4.05(c) të Kushteve të Përgjithshme deri në shumën që caktohet herë pas here për këtë qëllim në tabelën e seksionin IV, të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivit të Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi zbaton projektin nëpërmjet MIAP-së me ndihmën e Agjencive Pjesëmarrëse, për sa u takon aktiviteteteve të mëposhtme të reformës në sektorin publik, në lidhje me pjesët 1(a), 2(a) dhe 3(a) të Projektit, thjeshtimit të proceseve të biznesit, përmirësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike dhe parakushteve institucionale për realizimin e Programit të Reformës së ofrimit të shërbimeve me qendër qytetarin, të gjitha në përputhje me dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme.

3.02 Pa cenuar dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, përveç kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi do të sigurojë që Projekti të realizohet në përputhje me dispozitat e shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV Hyrja në fuqi dhe përfundimi

4.01 Kushti shtesë i hyrjes në fuqi përbëhet nga sa më poshtë, specifikisht që Huamarrësi, nëpërmjet MIAP-së, të ketë:

a) përgatitur dhe miratuar një Manual Operacionesh në një mënyrë të pranueshme për Bankën; dhe,

b) ngritur një njësi për menaxhimin e projektit, të përbërë nga staf i kualifikuar, me përvojë dhe sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën.



4.02 Kontrata hyn në fuqi nëntëdhjetë ditë (90) pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni V

Përfaqësimi; adresat

5.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i tij i Financave.

5.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Nr. 3, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri

Faks:

355 42228494

5.03 Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa kablllore: Teleks: Faksimile:

INTBAFRAD 248423(MCI) 1-202-477-

ose

6391

Washington, 64145(MCI)

D.C.

RËNË DAKORD në _____, në datën _____ dhe vitin e shkruar në fillim.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

SHTOJCA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Objektivi i Projektit është që të përmirësojë efikasitetin e ofrimit dhe të përdorimit të shërbimeve të përzgjedhura administrative në territorin e Huamarrësit.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Forcimi i sistemeve mbështetëse

a) Mbështetja e zbatimit të programit të Huamarrësit për thjeshtimin dhe përmirësimin e proceseve të punës së tij (Ristrukturimi i procesit të biznesit - BPR) për të reduktuar kohën që qytetarët shpenzojnë për të marrë shërbimet e kërkuara, nëpërmjet rimbursimit të Programit të Shpenzimeve të Miratuara (PSHM) për programin në fjalë (pjesa 1(a) PSHM).

b) Forcimi i kapaciteteve të ADISA-së dhe të Agjencive Pjesëmarrëse për të ofruar shërbime të përzgjedhura administrative nëpërmjet dhënies së asistencës teknike dhe trajnimit.

c) Rritja e kapaciteteve të Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit nëpërmjet, ndër të tjera, konvertimit të informacionit në format dixhital, duke përmirësuar bazat e të dhënave për të nxitur një përdorim më efikas të tyre, dhe përgatitja e programeve kompjuterike me anë të ofrimit të asistencës teknike dhe mallrave.

Pjesa 2: Rritja e bashkëveprimit të qytetarëve me ofrimin e shërbimeve

a) Mbështetja për zbatimin e programit të Huamarrësit për të përmirësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike të tij nëpërmjet, ndër të tjera: i) shpërndarjes së informacionit te publiku për shërbimet e qeverisë; ii) ofrimit të pranisë ndërvepruese në rrjetin e Internetit me anë të vërtetimit elektronik, deklarimit elektronik të tatimeve dhe pagesave elektronike; dhe iii) monitorimit të komenteve të qytetarëve dhe përmirësimeve në kryerjen e punëve, me anë të rimbursimit të PSHM-ve për programin në fjalë (pjesa 2(a) - PSHP).

b) Forcimi i kapacitetit të Huamarrësit për të përgatitur dhe për të zbatuar një gamë aktivitetesh të programit, duke përfshirë: i) programet e komunikimit; ii) ofrimin e stimuljeve aktorëve të ndryshëm për të garantuar zbatimin efikas të Projektit; iii) fushatat e zgjerimit të kontakteve me qytetarët dhe të ndërgjegjësimit të tyre; dhe iv) mekanizmat e marrjes së mendimeve të qytetarëve.

c) Kryerja e rregullimeve të vogla në zyrat e pritjes të institucioneve të zgjedhura të ofrimit të shërbimeve.

d) Ngritja e një Qendre Telefonike me anë të ofrimit të mallrave dhe asistencës teknike.

Pjesa 3: Krijimi i kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve



a) Mbështetja e zbatimit të programit të Huamarrësit për arritjen e parakushteve institucionale për programin e reformës së ofrimit të shërbimeve që kanë në qendër qytetarin, pra: i) miratimi i dokumentit të Programit të Reformës së ofrimit të shërbimeve publike me qendër qytetarin; dhe ii) kryerja e një vëzhgimi për të marrë informacion bazë krahasues për objektivat e Projektit, me anë të rimbursimit të Programit të Shpenzimeve të Miratuara (PSHM) për programin në fjalë (pjesa 3(a) PSHM).

b) Forcimi i aftësive të Huamarrësit për të ofruar shërbime publike nëpërmjet, ndër të tjera:

i) Hartimit dhe zbatimit të një programi për miratimin dhe zbatimin e reformave të propozuara që do të identifikohen nga ky Projekt;

ii) Përmirësimit të mbledhjes së të dhënave, me anë të vendosjes së standardeve të shërbimit, dhe bërjes së vlerësimeve të rregullta; forcimit të mjeteve të monitorimit dhe bërjen e kontroleve nga palë të treta dhe verifikimin e treguesve të lidhur me disbursimin (DLI); dhe

iii) Forcimit të kapaciteteve të ADISA-së për të menaxhuar projektin.

Pjesa 4: Qendra e Shërbimeve Publike dhe Menaxhimi i Projektit

a) Qendra e Shërbimeve Publike (QSHP):

i) Kryerja e një studimi për gjendjen aktuale të ofrimit të shërbimeve publike;

ii) Përgatitja e konceptit dhe projektit të modelit të QSHP-ve dhe mbështetja për ngritjen e Qendrës së Shërbimeve Publike;

iii) Ngritja e një mekanizmi për marrjen e mendimeve të qytetarëve për të nxitur përdorim efikas të modelit të Qendrës së Shërbimeve Publike.

b) Njësia e Menaxhimit të Projektit (NJMP)

Forcimi i kapacitetit të ADISA-së për të zbatuar Projektin, ndër të tjera, nëpërmjet punësimit të një menaxheri projekti, një specialisti të menaxhimit financiar, një specialisti administrativ dhe specialisti të prokurimeve.

SHTOJCA 2

REALIZIMI I PROJEKTTIT

Seksioni I. Masa institucionale dhe të lidhura me zbatimin

A. Masa institucionale

1. Njësia e Menaxhimit të Projektit

a) Huamarrësi nëpërmjet MIAP-it:

i) Kryen monitorimin e zbatimit të Projektit;

ii) Siguron që ADISA të ngrëjë dhe më pas të mbajë gjatë gjithë zbatimit të Projektit, një njësi të menaxhimit të projektit, me funksione dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën, si dhe stafin kyç, duke përfshirë një menaxher projekti, një specialist prokurimesh, një specialist të menaxhimit financiar, dhe një specialist për administratën, të gjithë të kualifikuar, me përvojë dhe me terma reference të pranuar për Bankën.

iii) Siguron që Njësia e Menaxhimit të Projektit të kryejë përgjegjësitë e menaxhimit të përgjithshëm të projektit, duke përfshirë: i) koordinimin e agjencive pjesëmarrëse dhe mbikëqyrjen e kontributeve teknike të tyre; ii) konsolidimin e dokumentacionit për Programin e Shpenzimeve të Miratuara, raportet teknike dhe informacionin për verifikimin e treguesve të lidhur me disbursimin - DLI; dhe iii) prokurimin dhe menaxhimin financiar.

2. Komiteti Drejtues i Projektit

Huamarrësi nëpërmjet MIAP-së:

a) mban gjatë gjithë zbatimit të projektit një Komitet Drejtues të Projektit (KDP).

b) siguron që KDP-ja: i) të mbledhet të paktën një herë në tre muaj; ii) të bëjë mbikëqyrjen e menaxhimit të projektit, duke përfshirë ndër të tjera, monitorimin e zbatimit të projektit, heqjen e pengesave; dhe iii) të sigurojë shkëmbimin e informacionit midis Agjencive Pjesëmarrëse.

3. Grupet ministrore të punës

a) Huamarrësi nëpërmjet MIAP-së:

i) Përdor dhe mban gjatë gjithë zbatimit të projektit, grupet ministrore të punës, të kryesuar nga MIAP, në përbërje të të cilëve ka përfaqësues të ministrive dhe agjencive të përfshira në projekt, me mandat dhe terma reference të pranueshme për Bankën.

ii) Garanton që sektori i informacionit dhe i komunikimit: A) të kryejë studime teknike për të mbledhur të dhënat bazë përkatëse krahasuese; B) të përfundojë rishikimin e ligjeve përkatëse dhe të konfirmojë vlefshmërinë e inventarit të reformës ligjore; dhe C) të rekomandojë proceset që duhen thjeshtuar, duke përfshirë reformat e nevojshme ligjore për të ofruar shërbime cilësore administrative.

4. Komiteti Ndërmintoror i Shërbimit Publik

Huamarrësi siguron që Komiteti Ndërmintoror i Shërbimit Publik të mbështesë zbatimin e



projektit, nëpërmjet ofrimit të: a) udhëzimeve strategjike për reformën e ofrimit të shërbimeve publike; b) mbikëqyrjen e agjencive të përfshira në Projekt; dhe c) rekomandime për të zgjidhur pengesat për zbatimin e projektit, të lidhura me agjencitë e përfshira në të.

5. Manuali i operacioneve

Pa u kufizuar te dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme, Huamarrësi nëpërmjet MIAP, siguron që:

a) Projekti të realizohet në përputhje me Manualin e Operacioneve, i cili parashikon politikat dhe procedurat që përdoren për të realizuar projektin, duke përfshirë ndër të tjera: i) rolet dhe përgjegjësitë e agjencive pjesëmarrëse dhe entiteteve të përfshira në Projekt; ii) një përshkrim të hollësishëm të Programit të Shpenzimeve të Miratuara; iii) grafikun e përafërt të zbatimit; iv) procedurat për marrjen, disbursimin dhe kontabilizimin e fondeve të projektit; v) treguesit për t'u përdorur për monitorimin dhe vlerësimin e Projektit; vi) procedurat për monitorimin, mbikëqyrjen, dhe vlerësimin e Projektit, duke përfshirë formatin dhe brendinë e raporteve të Projektit; g) treguesit e lidhur me disbursimet; dhe vii) procedurat e prokurimit dhe të menaxhimit financiar, duke përfshirë procedurat e përcaktuara qartë në lidhje me verifikimin dhe përpunimin e pagesave dhe regjistrimin dhe menaxhimin e Shpenzimeve të Miratuara të financuara nga të ardhurat e Huas; dhe

b) Përveç rasteve, kur Banka do të bjerë dakord ndryshe me shkrim, Manuali i Operacioneve nuk ndryshohet, hiqet, pezullohet ose shfuqizohet dhe në rast të ndonjë mospërputhjeje midis dispozitave të Manualit të Operacioneve dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

C. Antikorrupsioni

Huamarrësi siguron që Projekti të zbatohet në përputhje me dispozitat e Udhëzimeve Antikorrupsion.

E. Garancitë

1. Huamarrësi nëpërmjet MIAP-it:

a) E zbaton Projektin në përputhje me Planin e Menaxhimit Mjedisor (PMM) në një mënyrë të pranueshme për Bankën; dhe

b) I dërgon Bankës për miratim paraprak çdo rishikim të propozuar për t'u përfshirë në Planin e Menaxhimit Mjedisor në fjalë, dhe më pas i

përfshin rishikime të tilla në Planin e Menaxhimit Mjedisor, siç është rënë dakord me Bankën.

2. Në rast të një konflikti midis Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MIAP-së, siguron që realizimi i Projektit, të mos rezultojë në: i) marrjen e pavullnetshme të tokës, që shpie, në: A) zhvendosje apo humbje të strehimit; B) humbje të aseteve ose mundësive të shfrytëzimit të tyre; ose C) humbje të burimeve të të ardhurave ose mjeteve të jetesës për personat e prekur nga projekti, pavarësisht nëse këtyre personave u duhet ose jo të zhvendosen në një vendndodhje tjetër; ose ii) në kufizimin e pavullnetshëm për të hyrë në parqe ose zona të mbrojtura, të emëtuara të tilla ligjërisht, duke rezultuar në ndikime negative në mjetet e jetesës së tyre.

4. Në zbatimin e pjesës 4(a)(ii) të Projektit, Huamarrësi nëpërmjet MIAP-së siguron që termat e referencës për çdo konsultim të jenë të pranueshme për Bankën pas rishikimit të tyre prej saj, dhe për atë qëllim, terma të tillë reference duhet që përkatësisht të përfshijnë kërkesat e Politikave Mbrojtëse të Bankës në fuqi në atë kohë, siç përdoren në informacionin e dhënë nëpërmjet një ndihme të tillë teknike.

Seksioni II. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit

A. Raportet e Projektit

1. Huamarrësi nëpërmjet MIAP monitoron dhe vlerëson progresin e Projektit dhe përgatit Raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme dhe në bazë të treguesve të pranueshëm për Bankën. Secili nga raportet e Projektit mbulon një periudhë gjashtëmuajore dhe i jepet Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga një raport i tillë.

2. Për qëllimet e seksionit 5.08(c) të Kushteve të Përgjithshme, raporti për ekzekutimin e Projektit dhe të planit të lidhur që kërkohet sipas atij seksioni i jepet Bankës brenda një kohe jo më vonë se gjashtë muaj.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe kontrollet financiare

1. Huamarrësi mban ose merr masa që të mbahet një sistem menaxhimi financiar në



përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të Kushteve të Përgjithshme.

2. Huamarrësi bën që MIAP të përgatisë dhe t'i dërgojë Bankës jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, raporte financiare të ndërmjetme të paaudituar për Projektin, që mbulojnë atë semestër, në një formë dhe me një përmbajtje të pranueshme nga Banka.

3. Huamarrësi i kontrollon Pasqyrat e tij Financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09(b) të Kushteve të Përgjithshme. Çdo kontroll financiar mbulon periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit, duke filluar me vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e parë në bazë të Paradhënies për Përgatitjen e Projektit. Pasqyrat financiare të audituara për secilën periudhë të tillë i dërgohen Bankës jo më vonë se nëntë muaj pas përfundimit të një periudhe të tillë.

C. Auditimi i Treguesve të lidhur me disbursimin, raporti i auditimit të progresit të treguesve të lidhur me disbursimin (DLI)

1. Në zbatimin e pjesëve 1(a), 2(a) dhe 3(a) të Projektit, Huamarrësi, nëpërmjet MIAP-it, garanton që ADISA:

a) Jo më vonë se një muaj pas përfundimit të çdo semestri kalendarik ose në një datë të mëvonshme për të cilën është rënë dakord me Bankën, të përgatisë dhe t'i dërgojë Bankës një Raport të ndërmjetëm të paaudituar të progresit të treguesve të lidhur me disbursimin (ILD).

b) Jo më vonë se një muaj pas përfundimit të çdo viti kalendarik, ose në një datë të mëvonshme për të cilën është rënë dakord me Bankën, të bëjë një auditim të pavarur të Treguesve të lidhur me disbursimin i cili, ndër të tjera, të vërtetojë shkallën e plotësisimit së DLI-ve për vitin përkatës kalendarik, të mbuluar nga auditimi i DLI-ve.

c) Jo më vonë se një muaj pas përfundimit të çdo viti kalendarik, ose në një datë të mëvonshme për të cilën është rënë dakord me Bankën, të përgatisë dhe t'i dërgojë Bankës një raport të plotë auditimi të DLI-ve, të pranueshëm nga Banka, duke përfshirë të gjitha konstatimet dhe rezultatet e auditimit të DLI-ve, si edhe çdo vërtetim tjetër shtesë nga auditimi i DLI-ve, sipas kërkesave që Banka mund ta çmojë të arsyeshme të kryejë.

Seksioni III. Prokurimi

A. Të përgjithshme

1. Mallrat, Punimet, dhe Shërbimet jo të Konsulentëve. Të gjitha mallrat punimet dhe

shërbimet jo të konsulentëve që kërkohen nga Projekti dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huas, do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të referuara në seksionin I të Udhëzimeve të Prokurimeve dhe në dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e Konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve që nevojiten për pjesën 2 të këtij projekti dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huas, prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të referuara në seksionet I dhe IV të udhëzimeve të konsulentëve dhe me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Shprehjet me germa kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion, për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi të kontratave të veçanta nga ana e Bankës, i referohen metodës përkatëse të përshkruar në seksionet II dhe III të Udhëzimeve të Prokurimit ose seksioneve II, III, IV dhe V të Udhëzimeve të Konsulentëve, sipas rastit.

B. Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo të konsulentëve

1. Tenderi i hapur ndërkombëtar. Përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat prokurohen nëpërmjet kontratave që jepen mbi bazën e procedurave të tenderit të hapur ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo të konsulentëve. Përveç metodës së tenderit të hapur ndërkombëtar, për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo të konsulentëve për ato kontrata të përcaktuara në programin e prokurimit mund të përdoren edhe metodat e mëposhtme: a) Tenderi i hapur kombëtar që u nënshtrohet dispozitave shtesë që përmban paragrafi 3, i këtij seksioni; b) Blerje; dhe c) Kontraktim i drejtpërdrejtë.

3. Modifikime në procedurat e Huamarrësit për tenderin e hapur kombëtar

a) Procedurat e Tenderit të Hapur Kombëtar (THK) bazohet në procedurat e Tenderit të Hapur, siç përcaktohen në Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) të Shqipërisë (ligji nr. 9643, i datës 20 nëntor 2006, i ndryshuar), me kusht që, gjithsesi, procedura të tilla t'u nënshtrohen dispozitave të seksionit I dhe pikave 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimeve të Prokurimit dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

Procedurat e "Tenderit të hapur", siç përcaktohen në Ligjin e Prokurimit Publik të



Shqipërisë përdoren për të gjitha kontratat e financuara nga Banka.

b) Ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga konkurrimi dhe asnjë preferencë e ndonjë lloji nuk do t'u jepet ofertuesve vendas në procesin e tenderimit. Ndërmarrjet në pronësi të qeverisë në Shqipëri lejohet të paraqesin oferta vetëm nëse janë ligjërish dhe financiarisht autonome dhe operojnë sipas ligjit tregtar të Huamarrësit. Regjistrimi nuk përdoret si kriter vlerësues për kualifikimin e ofertuesve.

c) Ofertat hapen publikisht, në një vend, menjëherë pas mbarimit të afatit për paraqitjen e ofertave, në prani të përfaqësuesve që kanë zgjedhur të jenë të pranishëm.

Subjektet prokuruese përdorin modele tip tenderimi, të miratuara nga Banka.

e) Në rastin e ofertave me çmime më të larta, krahasuar me vlerësimin zyrtar, asnjë ofertë nuk shkualifikohet pa miratimin paraprak të Bankës.

f) Për dorëzimin e ofertave përdoret procedura me një zarf të vetëm.

g) Postkualifikimi përdoret vetëm për ofertuesin me vlerë më të ulët; asnjë ofertë nuk refuzohet në kohën e hapjes së ofertave për shkaqe kualifikimi.

h) Ofertuesit në formën e një ndërmarrjeje aksionare kanë përgjegjësi së bashku dhe veç e veç.

i) Përpara refuzimit të të gjitha ofertave dhe kërkimit të ofertave të reja, merret miratimi paraprak i Bankës.

j) Kontratat i jepen ofertuesit më të ulët, i cili është mjaftueshmërisht përgjegjës dhe që përcaktohet se është i kualifikuar për të kryer aktivitetin në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe të bëra me dije më parë për vlerësimin.

k) Pas tenderimit, negociatat me ofertën e vlerësuar si më e ulëta, ose me ofertues të tjerë nuk lejohen.

l) Kontratat afatgjata (më shumë se 18 muaj) përmbajnë dispozita të nevojshme për rregullimin e çmimit të pranueshëm nga Banka.

m) Garancia e ofertës dhe e kontratës janë në një format të përfshirë në dokumentet e tenderit të përmendur të germa “d” më lart. Garancia e ofertës është e vlefshme për 28 (njëzetë e tetë) ditë përtej periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës, ose përtej çdo periudhe zgjatjeje, nëse kërkohet. Asnjë parapagim nuk bëhet pa një garanci të përshtatshme parapagese.

n) Dokumenti dhe kontrata e tenderit, të konsideruara të pranueshme nga Banka, përfshijnë dispozita që deklarojnë politikën e Bankës për të sanksionuar ato firma apo individë që konstatohen se janë marrë me mashtrime dhe korrupsion, siç përcaktohen në Udhëzimet e Prokurimit.

o) Në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit, çdo dokument dhe kontratë tenderi financiar nga të ardhurat e Huas parashikon që ofertuesit, furnitorët dhe kontraktuesit dhe nënkontraktuesit e tyre, agjentët, personeli, konsulentët, ofruesit e shërbimeve ose furnitorët e lejojnë Bankën të inspektojë të gjitha llogaritë, procesverbalet dhe të gjitha dokumentet e tjera që lidhen me paraqitjen e ofertave dhe përmbushjen e kontratës dhe që ato të auditohen nga auditues të caktuar nga Banka. Pa u kufizuar në dispozitat e parashikuara në pikën 1.16(a)(v)(bb) të Udhëzimeve të Prokurimit, ato akte që kanë për qëllim të pengojnë materialisht ushtrimin nga ana e Bankës të inspektimit dhe të drejtave të kontrollit financiar të parashikuara në Udhëzimet e Prokurimit përbëjnë një praktikë penguese, siç përcaktohen në Udhëzimet e Prokurimit.

C. Metodatat e veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja në bazë të cilësisë dhe koston. Përveç kur parashikohet ndryshe në pikën 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen me kontrata të dhëna në bazë të përzgjedhjes së cilësisë dhe koston.

2. Metodat e tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Metodatat e mëposhtme, përveç atyre që bazohen në përzgjedhjen mbi bazën e cilësisë dhe koston, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato kontrata, të cilat janë specifikuar në planin e prokurimit: a) Përzgjedhje mbi bazën e cilësisë; b) Përzgjedhje në kuadër të një buxheti fiks; c) Përzgjedhje e koston më të ulët; d) Përzgjedhje e bazuar mbi kualifikimin e konsulentëve; e) Përzgjedhje e firmave të konsulentëve me një burim të vetëm; f) Procedurat e përcaktuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të udhëzimeve të konsulentëve për përzgjedhjen e konsulentëve individualë; dhe g) Procedura me një burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

D. Rishikimi nga Banka i vendimeve të prokurimeve



Plani i prokurimit i parashikon kontratat të cilat do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat i nënshtrohen një rishikimi të mëvonshëm nga Banka.

Seksioni IV. Tërheqja e të ardhurave të Huas

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas në përputhje me dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme, të këtij seksioni, dhe atyre udhëzimeve, të cilat mund të specifikohen nga Banka me njoftim për Huamarrësin (duke përfshirë “Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimin për projektet”, maj 2006, i cili është

rishikuar herë pas here nga Banka dhe që zbatohet për këtë Marrëveshje, bazuar në këto udhëzime), për të financuar shpenzimet e miratuara që përcaktohen në tabelën e dhënë në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të miratuara, të cilat mund të financohen nga të ardhurat e Huas (Kategoria), alokimet e shumave të Huas për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohen për shpenzimet e miratuara në secilën kategori.

Kategoria	Shuma e Huas së alokuar (e shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që duhen financuar (përfshirë tatimet)
1) Programi i shpenzime të miratuara sipas pjesëve 1(a), 2(a) dhe 3(a) të Projektit	22.895.000	100% deri në shumën e DLI-ve në aneksin 2, të shtojcës 2, të Marrëveshjes
2) Mallra, punime, shërbime jokonsulente, dhe shërbime të konsulentëve, kostot e trajnimit dhe operative sipas pjesëve 1(b), 1(c), 2(b), 2(c) dhe 3(b) dhe ë(4) të Projektit	4.431.750	100%
3) Kthimi i paradhënies së përgatitjes së projektit	1.900.000	Shuma e pagueshme në bazë të seksionit 2.07(a) të Kushteve të Përgjithshme
4) Tarifa fillestare	73.250	Shuma e pagueshme në bazë të seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07(b) të Kushteve të Përgjithshme.
5) Niveli më i lartë i normës së interesit ose primi i dyshemesë së normës së interesit		Shuma për t'u paguar në përputhje me seksionin 2.08(c) të kësaj Marrëveshjeje
SHUMA TOTALE	29.300.000	

B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të seksionit, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për:

a) PAGESA të bëra përpara datës së kësaj Marrëveshjeje, përveç tërheqjeve të bëra deri në një shumë të përgjithshme që nuk e kalon shumën prej 5.860.000 eurosh për pagesa të bëra përpara kësaj date, por në, ose pas datës 1 janar 2015, për programe të shpenzimeve të miratuara sipas Kategorisë 1, për disbursimin e parë, me kusht që Huamarrësi të ketë plotësuar kushtet e përmendura në “b” dhe “c” më poshtë.

b) PAGESA sipas Kategorisë 1 deri sa Huamarrësi të ketë dërguar të dhëna të pranueshme për Bankën se DLI 5 është plotësuar; dhe

c) PAGESA sipas Kategorisë 1 në lidhje me secilën DLI të plotësuar dhe për të cilën është paraqitur

një kërkesë për tërheqje, përveçse kur Huamarrësi ka dërguar të dhëna të pranueshme nga Banka dhe ka përcaktuar në Manualin e Operacioneve se pagesat për Programin e shpenzimeve të miratuara sipas linjave të buxhetit sektorial të Huamarrësit, të parashikuara në shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje, janë bërë nga Huamarrësi në përputhje me ligjet e zbatueshme të Huamarrësit dhe me rregullat dhe Manualin e Operacioneve.

2. Pa cenuar dispozitën e përcaktuar në pikën 1 të seksionit IV.B të kësaj shtojce, tërheqjet nga Huamarrësi sipas Kategorisë 1 bëhen në shumën e përcaktuar në rreshtin “Shuma e treguesve të lidhur me disbursimin - DLI”, në tabelën e aneksit 2, të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje, në varësi të dorëzimit në Bankë të të dhënave të kënaqshme se treguesit e lidhur me disbursimin –



DLI (dhe për të cilën është dërguar një kërkesë për tërheqje) janë arritur.

3. Në lidhje me sa më sipër, në rast se Banka përcakton, bazuar në të dhënat e përmendura në seksionin IV.B.1(c) dhe 2 më lart se:

a) DLI 5 është realizuar siç parashikohet në pikën 1(b) më lart, por se DLI 1 deri te DLI 4 nuk janë realizuar ose janë realizuar pjesërisht, atëherë pjesa e shumës korrespondues të DLI-së do të zbritet në proporcion me shkallën përkatëse të realizimit të DLI-së, sipas formulës së parashikuar në Manualin e Operacioneve, dhe çdo tepricë e patërhequr i këstit të kërkuar për vitin në fjalë, në lidhje DLI-në e porealizuar ose të realizuar pjesërisht, do të mbetet e disponueshme për tërheqje të mëvonshme.

b) DLI 5 nuk është realizuar, siç shprehet në seksionin IV.B.1(b) të kësaj shtojce, shuma e DLI-së prej 4,495,000 eurosh mbetet e disponueshme për tërheqje të mëvonshme posa që DLI 5 të realizohet në një mënyrë të pranueshme për Bankën ose mund të anulohet nga Banka.

4. Pavarësisht sa më sipër:

a) Në rast se Banka nuk merr prova të pranueshme për të se DLI 5 është realizuar dhe nuk ka e kryer disbursimin e të ardhurave të

Huas në bazë të Kategorisë 1 në lidhje me treguesit e lidhur me disbursimin - DLI1 deri te DLI 4 që janë realizuar, Banka vetëm në bazë të gjykimit të saj:

i) mund të autorizojë në një datë të mëvonshme, pasi të ketë marrë dëshmi të pranueshme për të, që tregojnë se treguesit e lidhur me disbursimin - DLI 5 janë arritur, tërheqjen e të ardhurave të mbajtura të Huas në lidhje me DLI 1 deri te DLI 4; ose

ii) mund të anulojë në çdo kohë, duke njoftuar Huamarrësin, shumën e të ardhurave të Huas të mbajtur në lidhje me DLI 1 deri te DLI 4, ose t'ua rialokojë shumën në fjalë treguesve të tjerë të lidhur me disbursimin.

iii) Nëse Banka vendos, në çdo kohë, se ndonjë pjesë e shumave të disbursuara nga Huamarrësi në Kategorinë 1 është përdorur për rimbursimin e shpenzimeve që nuk janë të pranueshme në kuadër të pagesave për programin e miratuar të shpenzimeve, apo se nuk janë në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1(b) dhe 2 të seksionit IV.B të kësaj shtojce, Huamarrësi do t'i rikthejë menjëherë një shumë të tillë Bankës, siç Banka do të specifikojë në njoftimin e saj për Huamarrësin.

5. Dita e mbylljes është 31 dhjetor 2020.



ANEKSI 2
TREGUESIT E LIDHUR ME DISBURSIMIN

Përshkrimi, synimet dhe shuma e DLI-së		Situata fillestare	Viti fiskal i Huamarrësit pas datës së hyrjes në fuqi						Përqindja totale e shumës së Huas (milion euro)
			VF 15	VF16	VF17	VF18	VF19	VF20	
DLI 1 Numri i shërbimeve të reja <i>online</i> me automatizim të Nivelit 3	Numri	0	0	15 më shumë se situata fillestare	35 (20 plus synimit që duhej arritur vitin e kaluar)	55 (plus synimit që duhej arritur vitin e kaluar)	75 (20 plus synimit për që duhej arritur në vitin 3)		
	Shuma e DLI-së e shprehur në milion euro)			2.750	1.800	0.900	0.900		6.350
DLI 2 Numri i shërbimeve publike prioritare me procese pune të rindërtuara (BPR)	Numri	0	0	Prodhimi dhe miratimi i hartave të ardhshme të ristrukturimit të procesit të punës (BPR) në 50 shërbime	Prodhimi i hartave të ardhshme BPR në 70 shërbimeve (20 mbi synimin për t'u arritur në vitin e mëparshëm)	Zbatimi i planit të ri të BPR-së për 70 shërbime	Prodhimi i hartave të ardhshme BPR në 100 shërbime (30 më shumë se synimi për t'u arritur në vitin e mëparshëm)		
	Shuma e DLI-së e shprehur në milion euro)			2.750	0.900	0.900	0.900		5.450
DLI 3 Numri i shërbimeve të përmirësuara të ofruara me shërbim të për klientët/ndërveprim në zyrën pritëse	Numri	0	0	0	70	90 (20 më shumë se synimi për t'u arritur vitin e mëparshëm)	110 (20 më shumë se synimi për t'u arritur vitin e mëparshëm)	130 (20 më shumë se synimi për t'u arritur vitin e mëparshëm)	
	Shuma e DLI-së e shprehur në milion euro)				1.400	0.900	0.500	0.500	3.300



DLI 4 Numri i shërbimeve me informacion të disponueshëm në platforma të shumëfishta	Numri	0	0	Përgatitja e planit promociional për 70 shërbime	Realizimi i planit promociional për 70 shërbime	90	110	130	
	Shuma e DLI-së e shprehur në milion euro)			1.300	0.500	0.500	0.500	0.500	3.300
DLI 5 Realizimi i parakushteve institucionale për Programin e Reformës së Ofrimit të Shërbimeve Publike me Qendër Qytetarin	Parakushtet institucionale për Programin e Reformës së Ofrimit të Shërbimeve Publike me Qendër Qytetarin	Jo	Po						
	Shuma e DLI-së e shprehur në euro)		4.495	0	0	0	0		4.495
SHUMA TOTALE			4.495	6.800	4.600	3.200	2.800	1.000	22.895



SHTOJCA 3 GRAFIKU I AMORTIZIMIT

1. Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të Huas dhe përqindjet e shumës totale të principalit të Huas të pagueshme në secilën datë të pagesës së principalit (përqindja e këstit). Nëse të ardhurat nga Huaja janë tërhequr plotësisht deri në datën e parë të pagesës së principalit, shuma e principalit të Huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit do të përcaktohet nga Banka, duke shumëzuar: a) Tepricën e Huas së tërhequr deri në datën e parë të pagesës së principalit; me b) Përqindjen e këstit për secilën datë të pagesës së principalit, kjo shumë e shlyeshme mund të ndryshohet, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të referuar në paragrafin 4 të këtij grafiku, për të cilin zbatohet konvertimi i monedhës.

Data e pagesës së principalit	Përqindja e këstit (e shprehur në përqindje)
Çdo 15 janar dhe 15 korrik Duke filluar më 15 janar 2023, Deri më 15 janar 2035	3.85%
Në 15 korrik 2035	3.75%

2. Nëse të ardhurat e Huas nuk janë tërhequr plotësisht deri në datën e parë të pagesës së principalit, atëherë shuma e principalit të Huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagimit të principalit do të përcaktohet si më poshtë:

a) Në masën që ndonjë sasi e të ardhurave të Huas është tërhequr, duke filluar nga data e parë e pagesës së principalit, Huamarrësi do të shlyejë balancën e Huas së tërhequr deri në atë datë në përputhje me pikën 1 të këtij grafiku.

b) Çdo shumë e tërhequr pas datës së parë të pagesës së principalit do të shlyhet në çdo datë të pagesës së principalit që bie pas datës së kësaj tërheqjeje, në shumën e përcaktuara nga Banka, duke shumëzuar shumën e secilës nga këto tërheqje me një thyesë, numëruesi i së cilës është përqindja fillestare e këstit të specifikuar në tabelën e pikës 1 të këtij grafiku për datën e pagesës së principalit në fjalë (përqindja fillestare

e këstit) dhe emëruesi i së cilës është shuma e të gjitha përqindjeve fillestare të këstit të mbetur për datat e pagesës së principalit që bien në këtë datë, ose pas kësaj date, këto shuma të shlyeshme mund të rregullohen, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të referuar në pikën 4 të këtij grafiku, për të cilat zbatohet një konvertim monedhe.

3. a) Shumat e Huas të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë përpara çdo date të pagesës së principalit do të trajtohen, vetëm për qëllimin e llogaritjes së shumave të principalit të pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit, si të tërhequra dhe të papaguara në datën e dytë të pagesës së principalit, që bie pas datës së tërheqjes dhe do të jenë të shlyeshme në secilën datë të pagesës së principalit, duke filluar nga data e dytë e pagesës së principalit që bie pas datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht nga dispozitat e nënpikës “a” të kësaj pike, nëse në çdo moment Banka fut një sistem të faturimit në datën e kërkuar sipas të cilit faturat lëshohen në datën, ose pas datës përkatëse të pagesës së principalit, dispozitat e kësaj nënpike nuk do të jenë më të zbatueshme për tërheqjet e bëra pas miratimit të këtij sistemi faturimi.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij grafiku, pas një konvertimi monedhe për të gjithë ose ndonjë pjesë të tepricës së Huas së tërhequr në një monedhë të miratuar, shuma e konvertuar në këtë mënyrë në monedhën e miratuar, e cila është e pagueshme në çdo datë të pagesës së principalit që ndodh gjatë periudhës së konvertimit, do të përcaktohet nga Banka, duke shumëzuar këtë shumë në monedhën e emërimit të saj menjëherë përpara konvertimit, ose me: i) kursin e këmbimit që pasqyron shumën e principalit në monedhën e miratuar të pagueshme nga Banka, sipas transaksionit kufizues të riskut të investimit të monedhës që lidhet me konvertimin; ose ii) nëse Banka vendos në këtë mënyrë në përputhje me udhëzimet e konvertimit, me komponentin e kursit të këmbimit të normës së kontrollit.

5. Nëse teprica e Huas është shprehur në më shumë se një monedhë Huaje, dispozitat e këtij grafiku do të zbatohen veçmas për shumën e emërtuar në secilën Hua.



SHTOJCA 4
PROGRAMET E SHPENZIMEVE TË PRANUESHME
LINJAT E BUXHETEVE SEKTORIALE

Programi i shpenzimeve të pranuar – Institucione publike jobuxhetore	
Agjencia – Institucione publike jobuxhetore	Kodi kompjuterik dhe përshkrimi
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme	600 pagat; dhe 601 kontributet e sigurimeve shoqërore

Programi i shpenzimeve të pranuar – Institucione buxhetore				
Agjencia – Institucione buxhetore	Ministritë e linjës/ Kodi i institucionit	Kodi kompjuterik dhe përshkrimi	Kodi i Programit	Përshkrimi i Programit
Ministria e Brendshme	16 kodet e bashkive	600 pagat; dhe 601 kontributet e sigurimeve shoqërore	01170	Të dhënat e Regjistrimit të Gjendjes Civile
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	87/1087006	600 pagat; dhe 601 kontributet e sigurimeve shoqërore	01140	Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit
Agjencia për ofrimin e shërbimeve të integruara në Shqipëri (ADISA)	87/1087017	600 pagat; dhe 601 kontributet e sigurimeve shoqërore	01160	Shërbimet e përgjithshme publike II

SHTESË

Seksioni I. Përkufizime

1. “ADISA” nënkupton qendrën e Huamarrësit për ofrimin e shërbimeve të integruara publike në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave të Huamarrësit nr. 693, të datës 22 tetor 2014 (të ndryshuar) ose pasuesin e saj ligjor në këtë post.

2. “Udhëzimet Antikorrupsion” nënkuptojnë “Udhëzimet për parandalimin dhe luftën ndaj mashtrimeve dhe korrupsionit në projekte të financuara nga Huaja e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Kreditë dhe Grantet e Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011.

3. “Politikat Mbrojtëse të Bankës” nënkuptojnë politikat dhe procedurat e punës së Bankës, të përcaktuara në manualin e operacioneve të Bankës dhe të identifikuar, si OP/BP 4.01, 4.04, 4.09, 4.10, 4.11, 4.12, 4.36, 4.37, 7.50 dhe 7.60, ndërsa manuali në fjalë ndryshohet herë pas here.

4. “Kategori” nënkupton një ndarje të përcaktuar në tabelën e seksionit IV, të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

5. “Qendër telefonike” nënkupton një zyrë qendrore të përdorur nga Huamarrësi për t’iu përgjigjur pyetjeve që bëhen me telefon në lidhje me shërbimet publike administrative.

6. “Qendra e Shërbimeve Publike” ose “QSHP” nënkupton një hapësirë të përcaktuar fizike ku qytetarët mund të marrin shërbime të administruara nga ADISA, drejtpërdrejt ose tërthorazi.

7. “Programi i reformës së ofrimit të shërbimeve publike me qendër qytetarin” nënkupton planin e propozuar nga Huamarrësi për përmirësimin e shërbimeve publike të përshkruara në “Dokumentin e Politikës së Reformës: Novacion kundër Programit të korrupsionit 2016–2020”.

8. “Udhëzime për konsulentët” nënkupton “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve në bazë të Huas së BERZH-së dhe Kredive dhe Granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore” të janarit 2011 (të rishikuar në korrik 2014).

9. “Tregues të lidhur me disbursimin” ose “DLI” nënkupton një grup treguesish, siç përcaktohen në aneksin 2 të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe në Manualin e Operacioneve (siç do të quhen më tej në këtë dokument), ndërsa tregues të tillë u referohen treguesve specifikë të produkteve dhe rezultateve që matin përmirësimin e përbushjes së detyrave të cilësisë dhe mundësive për marrjen e shërbimeve administrative të ofruara nga Huamarrësi.

10. “Raporti i auditimit të DLI-ve” nënkupton çdo raport të përgatitur dhe të dërguar Bankës sipas



seksionit II.C.1(c) të grafikun 2 të kësaj Marrëveshje.

11. “Shuma e DLI-ve” nënkupton shumën e të ardhurave të Huas të përcaktuara në rreshtin e titulluar “Shuma e DLI-ve” në tabelën, në aneksin 2, të grafikut 2, të kësaj Marrëveshje për vitin kalendarik korrespondues.

12. “Raporti i progresit të DLI-ve” nënkupton secilin nga raportet e ndërmjetme të paaudituar, që përmbajnë hollësi për matjen e nivelit të arritjes së DLI-ve të referuar në seksionin II.C.1(a) të grafikut 2 të kësaj Marrëveshjeje.

13. “PPM” ose “Programe të shpenzimeve të miratuara” nënkuptojnë një bashkësi shpenzimesh për pagat dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore të bëra nga Huamarrësi në lidhje me agjencitë pjesëmarrëse, siç tregohet në zërat e buxhetit sektorial të Huamarrësit të përcaktuara në shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me pjesët 1(a), 2(a) dhe 3(a) të Projektit..

14. “Aplikimi elektronik” nënkupton sistemet me bazë elektronike për ruajtjen, katalogimin dhe nxjerrjen e dokumenteve, në të cilin qytetarët mund të bëjnë kërkesa dhe dërgojnë dokumente të tjera nëpërmjet ndërveprimit në faqen e internetit.

15. “Plani i menaxhimit mjedisor” ose “PMM” nënkupton planin e Huamarrësit, “Plani mjedisor për ndërtimin e qendrës së re të shërbimeve publike”, i prillit 2015, në një formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka, duke përfshirë udhëzimet për zbutjen e ndikimeve mjedisore të cilat mund të shkaktohen nga kryerja e punimeve të vogla në zyrat pritëse, në bazë të pjesës 2(c) të Projektit, duke dhënë hollësi për masat e menaxhimit të rrezeve të mundshme mjedisore, reduktuar dhe/ose kompensuar ndikimet negative mjedisore, bashkë me masat e duhura institucionale, monitoruese dhe raportuese, të afta për të siguruar zbatimin e duhur dhe ndjekjen e vazhdueshme të përmbushjes së kushteve të tij, ndërsa një plan i tillë mund të ndryshohet dhe/ose plotësohet herë pas here me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

16. “Pagesa elektronike” nënkupton pranimin e pagesave elektronike për transaksione *online*.

17. “VF” nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit.

18. “Kushte të Përgjithshme” nënkupton “Kushtet e Përgjithshme të Huas së Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim”, të datës 12 mars 2012, me modifikimet e përcaktuara në

seksionin II të kësaj bashkëlidhjeje.

19. “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile” nënkupton regjistrat civilë të Huamarrësit të ngritur dhe funksionalë, sipas Ligjit nr. 10129, të datës 11 nëntor 2009 (i ndryshuar), ose pasuesin e tij.

20. “TIK” nënkupton Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit.

21. “Parashkushte institucionale për programin e reformës së ofrimit të shërbimeve publike me qendër qytetarin” nënkupton veprimet dhe aktivitetet e referuara në pjesën 3 (a) të Projektit.

22. “Komiteti Ndërmjësor i Shërbimeve Publike” nënkupton një komitet të ngritur nga Huamarrësi në bazë të Urdhrit nr. 176 të datës 16 tetor 2013 për bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e procesit të futjes së reformave në shërbimet publike dhe i referuar në seksionin I.A.4 të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

23. “ZRPP” nënkupton Zyrën e Huamarrësit për Regjistrimin e Pasurive të Patundshme ose pasuesin e tij ligjor.

24. “Automatizim i nivelit 3” nënkupton shërbime me prani ndërvepruese në internet, duke përfshirë vërtetimin elektronik, aplikimin elektronik dhe pagesat elektronike. Automatizimi i nivelit 3 përcaktohet në një Sondazh të Kombeve të Bashkuara për qeverisjen elektronike (2014): http://unpan3.un.org/egovkb/Portals/egovkb/Documents/un/2014-Survey/E-Gov_Complete_Survey-2014.pdf.

25. “MB” nënkupton Ministrinë e Brendshme të Huamarrësit ose pasuesin e saj ligjor.

26. “Grupe ministrore të punës” nënkupton një grup zyrtarësh të ministrive, i ngritur dhe që vepron në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 236, i datës 24 shtator 2014 dhe i referuar në seksionin 1.A.3 të shtojcës së kësaj Marrëveshjeje.

27. “MIAP” nënkupton Ministrinë e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ose pasuesin ligjor të saj.

28. “Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit” nënkupton një institucion të ngritur në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 703, të datës 29 nëntor 2014 (i ndryshuar).

29. “Kostot operative” nënkupton shpenzimet e arsyeshme në rritje që shkaktohen nga Projekti dhe që përbëhen nga shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve, blerjen e pajisjeve, materialeve të zyrave, kostot e komunikimit,



kostot e reklamës dhe të karburantit dhe kostot për vizitat në terren (duke përjashtuar pagat e punonjësve civilë të qeverisë).

30. “Manuali i operacioneve” nënkupton manualin e Huamarrësit, i pranuar nga Banka, të datës ____dhe i miratuar nga Huamarrësi, dhe i referuar në seksionin__ e shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe grafikët e saj, duke qenë se ai mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

31. “Agjencitë pjesëmarrëse” nënkupton institucionet e mëposhtme të Huamarrësit, konkretisht, ADISA-në, ZRPP-në, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile të Ministrisë së Brendshme.

32. “NJMP” nënkupton Njësinë e Menaxhimit të Projektit, të referuar në seksionin I.A.1 të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

33. “Paradhënie për përgatitje” nënkupton paradhënien që i referohet seksioni 2.07(a) i Kushteve të Përgjithshme, dhënë nga Banka Huamarrësit, në përputhje me zbatimin e Letërmarrëveshjes, të miratuar nga Parlamenti më 11 qershor 2015.

34. “Udhëzime prokurimi” nënkupton “Udhëzimet: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo të konsulencës, në bazë të Huas së BNRZH-së dhe Kredive dhe Granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të janarit 2011 (të rishikuara në korrik 2014).

35. “Plan prokurimi” nënkupton planin e prokurimeve të Projektit të Huamarrësit të datës 18 qershor 2015, dhe të referuar në nënpikën 1.18 të Udhëzimeve të Prokurimit dhe në pikën 1.25 të Udhëzimeve të Konsulentit, ndërsa ai mund të ndryshojë herë pas here në përputhje me dispozitat e pikave në fjalë.

36. “KDP” nënkupton Komitetin Drejtues të Projektit të referuar në seksionin 1.A.2 të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

37. “Shërbime të përzgjedhura administrative” nënkupton listën e shërbimeve të përzgjedhura nga Huamarrësi, në përputhje me kriteret e përcaktuar në Manualin e Operacioneve, siç mund të ndryshojë herë pas here, me miratim paraprak me shkrim të Bankës.

38. “Kontributet e sigurimeve shoqërore” nënkupton kontributet financiare që jep

Huamarrësi në të mirë të qytetarëve në përputhje me Ligjin nr. 7703, të datës 11 maj 1993 (i ndryshuar).

39. “Trajnim” nënkupton kostot e arsyeshme të lidhura me trajnimin, seminarët dhe vizitat studimore, pjesëmarrjen e personelit të përfshirë në aktivitetet e projektit, i cili konsiston në kostot e udhëtimit dhe dietat për trajnim, pjesëmarrësit e seminareve dhe të vizitave studimore, kostot e lidhura me sigurimin e shërbimeve të trajnerëve, marrjen me qira të mjediseve të trajnimit dhe të seminareve, përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve të trajnimit dhe të seminareve, dhe kosto të tjera të lidhura drejtpërdrejt me kurset e trajnimit, seminarët ose pjesëmarrjen në vizita studimore (por duke përjashtuar kostot e shërbimeve të konsulentëve).

Seksioni II. Modifikimet e Kushteve të Përgjithshme.

Kushtet e Përgjithshme janë ndryshuar si më poshtë:

1. Në Tabelën e Lëndës, referencat e seksioneve, emrat e seksioneve dhe numrat e seksioneve janë modifikuar për të pasqyruar modifikimet e paraqitura në pikat më poshtë.

2. Seksioni 3.01.(Pagesa fillestare) është modifikuar dhe lexon si vijon:

“Seksioni 3.01. Pagesa fillestare; Tarifa e angazhimit

a) Huamarrësi i paguan Bankës një pagesë fillestare në masën e specifikuar në Marrëveshjen e Huas (Pagesa fillestare).

b) Huamarrësi i paguan Bankës një tarifë angazhimi për Bilancin e patërhequr të Huas në masën e specifikuar në Marrëveshjen e Huas (Tarifa e angazhimit). Detyrimi për të paguar tarifën e angazhimit lind duke filluar nga një datë gjashtëdhjetë ditë pas datës së Marrëveshjes së Huas deri në datat përkatëse në të cilat shumat tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Huas ose anulohen. Tarifa e angazhimit bëhet e pagueshme në gjysmën e vitit në fundin e çdo datë pagese”.

3. Te Shtesa, Përkufizimet, të gjitha referencat përkatëse të numrat e seksioneve dhe pikave janë modifikuar, sipas nevojës, për të pasqyruar modifikimet e paraqitura në pikën 2 më lart.

4. Shtesa është modifikuar duke i përfshirë në pikë të re me numër 19, me përkufizimin që vijon “Tarifa e angazhimit” dhe duke rinumëruar paragrafët e mëposhtëm përkatësisht:



“19. “Tarifa e angazhimit” nënkupton tarifën e angazhimit të specifikuar në Marrëveshjen e Huas për qëllimet e seksionit 3.01(b).”

Në rast se Huamarrësi zgjedh ACLC-në e parashikuar te seksioni 2.09 i kësaj Marrëveshjeje, shtoni modifikimin e mëposhtëm në përkufizimin e “Datës së konvertimit” dhe pikat e mëposhtme të rinumëruara të këtij seksioni II, përkatësisht:

[5. Pika e rinumëruar 21 (fillimisht pika 20) e bashkëlidhjes (Data e konvertimit) modifikohet dhe lexon si më poshtë:

“21. “Data e konvertimit” në rastin e një konvertimi nënkupton datën e ekzekutimit apo një datë të tillë tjetër që do ta përcaktojë Banka, në të cilët hyn në fuqi konvertimi, sikurse përcaktohet më tej në Udhëzimet e Konvertimit; me kusht që nëse Marrëveshja e Huas parashikon konvertimet automatike në monedhën e miratuar në momentin e tërheqjes së shumave të Huas, data e konvertimit do të jetë data e tërheqjes nga llogaria e Huas e shumë për të cilën është kërkuar konvertimi.”]

5. Në pikën e rinumëruar 49 (fillimisht pika 48) të bashkëlidhjes, përkufizimi i “Pagesës fillestare” modifikohet duke e zëvendësuar referencën në seksionin 3.01 me seksionin 3.01(a).

6. Në pikën e rinumëruar 68 (fillimisht pika 67) e bashkëlidhjes, përkufizimi i termit “Pagesa e Huas” është modifikuar dhe lexon si më poshtë:

“68. “Pagesa e Huas” nënkupton çdo shumë të pagueshme nga Palët e Huas, në bazë të Marrëveshjes ligjore ose këtyre Kushteve të Përgjithshme, duke përfshirë (por jo duke u kufizuar te) çdo shumë e Tepricës së tërhequr të Huas, interesin, pagesën fillestare, tarifën e angazhimit, interesin me normë automatike (nëse ka), çdo prim parapagimi, çdo tarifë transaksioni për një konvertim, ose ndërprerje të parakohshme të konvertimit, tarifën e ndryshueshme të përcaktimit të shtrirjes (nëse ka), çdo prim të pagueshëm me vendosjen e një tavani për normën e interesit apo një dyshemeje për normën e interesit, dhe çdo shumë dëmshpërbluese të pagueshme nga Huamarrësi.”

7. Në pikën e rinumëruar 73 (fillimisht pika 72) të bashkëlidhjes, përkufizimi i “Datës së pagesës” është modifikuar duke hequr fjalën “është” dhe duke përfshirë fjalët “dhe tarifa e angazhimit janë” pas fjalës “interes”.

LIGJ

Nr. 4/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE E MINISTRIA E FINANCAVE, DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, NË LIDHJE ME LEHTËSIMIN E MBËSHTETJES SË AGROBIZNESIT, BERZH - SHQIPËRI, LLOGARI BASHKËPUNIMI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave e Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në lidhje me lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit, BERZH - Shqipëri, llogari bashkëpunimi, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.1.2016

Shpallur me dekretin nr. 9419, datë 9.2.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE DHE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE BANKA
EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, NË LIDHJE ME LEHTËSIMIN E
MBËSHTETJES SË AGROBIZNESIT, BERZH
– SHQIPËRI, LLOGARI BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje (Marrëveshja) është lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (Ministria) e Ministria e Financave (Ministria e Financave) dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka” apo “BERZH”) (më poshtë secila e referuar si “Palë” dhe së bashku si “Palët”), në lidhje me Lehtësimin e Mbështetjes së Agrobiznesit, BERZH – Shqipëri, Llogari Bashkëpunimi (Llogaria).

Duke pasur parasysh se:

A. Banka është e autorizuar, sipas nenit 20 të Marrëveshjes për themelimin e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi me ndonjë njësi publike ose private;

B. Ministria është e autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje për mbështetje për aktivitetet e bashkëpunimit të zhvillimit, të cilat janë në përputhje me qëllimin dhe funksionet e Bankës;

C. Ministria e Financave është e autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje për implikimet e saj financiare për Republikën e Shqipërisë;

D. Banka ka zhvilluar Lehtësimin e Mbështetjes së Agrobiznesit në Shqipëri, një kuadër financimi, sipas të cilit BERZH-i do të sigurojë linja kredie dhe pjesëmarrje të pafinancuar për ndarjen e rrezikut/riskut mbi bazë portofoli për bankat dhe institucionet mikrofinanciare në Republikën e Shqipërisë, për kreditimin e agrobizneseve lokale, siç përshkruhet në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje (Lehtësim).

E. Ministria dëshiron të vërë në dispozicion të Bankës fonde të bashkëpunimit, që do të përdoren për financimin e veprimtarive që do të kryhen nga Banka, me qëllim të zbatimit të Lehtësimit. BERZH-i ka rënë dakord për të menaxhuar dhe

administruar fondet e bashkëpunimit të vëna në dispozicion të saj nga Ministria, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Si rrjedhojë, palët bien dakord si më poshtë:

I – KRIJIMI I LLOGARISË

Neni 1

Llogaria

Palët në këtë mënyrë krijojnë instrumentin për Lehtësi Mbështetjeje Agrobiznesi - Llogaria për Bashkëpunim BERZH - Shqipëri (Llogaria).

II - BURIMET

Neni 2

Shuma e vënë në dispozicion nga Ministria për Bankën

Ministria duhet t'i vërë në dispozicion fondit të bashkëpunimit të BERZH-it shumën prej 36.000.000 eurosh (tridhjetë e gjashtë milionë euro) mbi baza jo të rimbursueshme, përveç kur parashikohet në nenin 18.2 (c) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Burimet

Fondet e bashkëpunimit që menaxhohen dhe administrohen nga BERZH-i sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje (Burimet), përbëhen nga:

a) Fondet e bashkëpunimit të vëna në dispozicion të BERZH-it në përputhje me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;

b) Plotësimet vihen në dispozicion të BERZH-it në përputhje me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje;

c) Çdo e ardhur e realizuar nga investimi, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, të fondeve në Llogari; dhe

d) Çdo fond që mbulohet nga Banka në përputhje me nenin 9.3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Përdorimi i Burimeve

4.1 Burimet do të përdoren për të financuar marrëveshjet për ndarjen e riskut, në formën e një mbulimi të parë të rrezikut/riskut të humbjes (Aktiviteti) në lidhje me zbatimin e Lehtësimit në Republikën e Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë, Burimet e Llogarisë mund të përdoren për të financuar:



a) marrëveshjet për ndarjen e riskut, në formën e mbulimit të parë të rrezikut të humbjes, siç përshkruhet në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) aktivitete të tjera të tilla që mund të bihen dakord herë pas here me shkrim ndërmjet Palëve.

4.2 Burimet do të përdoren edhe për të paguar shpenzimet e kthimit, në përputhje me nenin 9.3 (nëse ka) dhe tarifës administrative në përputhje me nenin 4.3 si më poshtë.

4.3 Banka ka të drejtë të zbresë dhe të mbajë një tarifë administrative të barabartë me 1% të shumës së fondeve të bashkëpunimit të vëna në dispozicion në përputhje me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe Plotësimit, në lidhje me kostot e menaxhimit dhe administrimit të Burimeve. Një tarifë e tillë administrative do të zbritet nga fondet e bashkëpunimit pas marrjes së tyre nga Banka në Llogarinë Bankare.

Banka ka të drejtë të rregullojë shumën e taksës administrative që do të ngarkohet në përputhje me rishikimet e ardhshme të politikave dhe procedurave të Bankës mbi tarifën e donatorëve. Banka duhet të informojë me shkrim Ministrinë për shumën e tarifës së zbatuar të taksës administrative sa më shpejt të jetë e mundur pas rishikimeve të tilla, nëse ka.

Neni 5

Plotësimet

Ministria, në çdo kohë, me pëlqimin e Bankës, mund të vërë në dispozicion të Bankës dhe të paguajë në Llogarinë, shumën/at, përveç shumës së vënë në dispozicion në zbatim të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje (Plotësim/e). Çdo plotësim do të bihet dakord me shkrim dhe do të formojë një pjesë të Burimeve dhe do të rregullohen nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje, siç mund të ndryshohet herë pas here nga Palët në përputhje me nenin 19 të këtij akti.

Neni 6

Kushtet e pagesës

6.1 Ministria do të paguajë fondet e bashkëpunimit që vë në dispozicion të Bankës në zbatim të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje në të holla, në 3 këste në llogarinë si më poshtë:

a) 10,000,000 euro (dhjetë milionë euro) pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;

b) 12,000.000 euro (dymbëdhjetë milionë euro) nga 31 janari 2017;

c) 14,000,000 euro (katërbëdhjetë milionë euro) nga 31 janari 2018.

6.2 Fondet e bashkëpunimit të vëna në dispozicion të Bankës në zbatim të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose plotësim/et e marra në çdo monedhë tjetër përveç euros do të kthehen/konvertohen pas marrjes nga Banka në euro dhe shuma totale në euro e konvertuar në këtë mënyrë do të konsiderohet të jetë shuma e vënë në dispozicion dhe në Llogari nga Ministria.

6.3 Të gjitha pagesat në Llogari do të kryhen pas paraqitjes së kërkesës për pagesë nga Banka për Ministrinë.

Neni 7

Ndarja e burimeve

7.1 Burimet duhet të mbahen të ndara nga burimet e kapitalit të zakonshëm dhe nga çdo Burim Fondesh të Veçanta të Bankës, siç janë përcaktuar apo referuar në termat e Marrëveshjes Themeluese të Bankës.

7.2 Në asnjë rrethanë Burimet nuk do shënohen në llogari ose nuk do të përdoren për shlyerjen e humbjeve apo detyrimeve që rrjedhin nga veprimet ose aktivitetet e tjera të Bankës për të cilat Burimet nuk ishin kryer apo miratuar fillimisht.

7.3 Në asnjë rrethanë burimet e zakonshme të kapitalit të bankës ose burimet e fondeve të veçanta të Bankës do të ngarkohen ose përdoren për shlyerjen e humbjeve apo detyrimeve që rrjedhin nga operacionet ose aktivitetet e tjera për të cilat burimet janë përdorur apo kryer fillimisht.

II - QEVERISJA

Neni 8

Përdorimi i Burimeve

8.1 Kur lindin rrethana që ndikojnë ndjeshëm në zbatimin, përshkrimin dhe/ose të buxhetit të çdo aktiviteti të miratuar, Banka do të informojë pa vonesë Ministrinë për rrethana të tilla dhe Banka dhe Ministria do të diskutojnë veprimet/masat e duhura që duhet të ndërmerren me qëllim trajtimitin e rrethanave të reja.

Neni 9

Administrimi i Burimeve

9.1 Banka do të jetë përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e burimeve, në përputhje me



dhe në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje. Banka do të ushtrojë të njëjtin kujdes dhe përkushtim në kryerjen e funksioneve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me administrimin dhe menaxhimin e fondeve të saj të tjera të bashkëpunimit.

9.2 Banka mund të miratojë procedura të tilla të brendshme në përputhje me këtë Marrëveshje, nëse mund të çmohet e nevojshme ose e përshtatshme për një administrim efikas të Burimeve.

9.3 Në rast të keqpërdorimit apo keqpërdorimit të dyshuar të ndonjë pjese të burimeve nga ndonjë palë e tretë për të cilat shuma të tilla janë paguar nga Banka, Banka, në përputhje me politikat dhe procedurat e saj përkatëse, mund të ndërmarrë procedurën e kthimit. Çdo pjesë e kthyer e Burimeve do të kreditohet përsëri në llogari dhe do të përdoret për qëllimet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje. Kostoja e këtyre procedurave do t'i ngarkohet Llogarisë. Në rast të fondeve të pamjaftueshme në llogarinë për të mbuluar këto shpenzime, Banka do të konsultohet me Ministrinë nëse do të fillojë ose vazhdojë procedurën e kthimit, në bazë të konfirmimit të Ministrisë se kostot e shkaktuara do të mbulohen veçmas prej tij.

IV – VEPRIMET E LLOGARISË

Neni 10

Prokurimi

Përveç rasteve kur Banka dhe Ministria bien dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, shërbimeve dhe/ose punëve të nevojshme për zbatimin e çdo Veprimtarie në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe që financohet nga Burimet, si dhe administrimin dhe/ose zbatimin e ndonjë dispozite të një marrëveshjeje të lidhur midis bankës dhe palëve të treta në lidhje me menaxhimin dhe/ose administrimin e Burimeve dhe/ose Aktivitetit, do të kryhet në përputhje me politikat dhe procedurat e zbatueshme të Bankës, duke përfshirë por pa u kufizuar të Politikat dhe Rregullat e Prokurimit të Bankës (PP & R).

Neni 11

Llogaria Bankare

Banka do të hapë dhe mirëmbajë një llogari të veçantë me kamatë bankare në euro për t'u njohur si Llogari Bashkëpunimi për Lehtësimin e Mbështetjes së Agrobiznesit, BERZH - Shqipëri (Llogari Bankare) në të cilën fondet e vëna në

dispozicion të Bankës në zbatim të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe riplotësim, nëse ka, do të paguhet nga Ministria.

Neni 12

Investimi dhe Këmbimi Valutor

12.1 Banka mund të investojë dhe rinvestojë Burimet në varësi të disbursimeve të tyre aktuale. Të ardhurat nga një investim i tillë i Burimeve do të kreditohen në llogari dhe do të jenë në dispozicion për përdorim në përputhje me këtë Marrëveshje. Të gjitha shumatat në lidhje me mirëmbajtjen e llogarisë bankare, duke përfshirë detyrimet bankare dhe interesin negativ, do të zbriten nga llogaria.

12.2 Banka mund të shkëmbejë lirisht Burimet në monedha të tjera, siç mund të lehtësojë përdorimin e tyre në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Banka nuk do të jetë përgjegjëse për Ministrinë në lidhje me ndonjë humbje valutore për këtë.

Neni 13

Llogaritë dhe Auditimi

Banka duhet të mbajë llogari dhe të dhëna të ndara në lidhje me Burimet, dhe çështje të tilla si regjistra dhe llogari që do të auditohen nga auditues të jashtëm të bankës në fund të çdo viti financiar të Bankës.

Neni 14

Transparenca

Banka do të garantojë që Ministria të informohet në lidhje me Aktivitetin e financiar me Burimet në mënyrën e duhur.

Neni 15

Kërkesat për raportim

Banka duhet t'i raportojë Ministrisë për përdorimin e Burimeve dhe zbatimin e Aktivitetit të financiar me Burimet si më poshtë:

i) një raport progresi vjetor të përgatitur në përputhje me procedurat e BERZH-it që detajon aktivitetet e ndërmarra, duke theksuar progresin e arritur në lidhje me Aktivitetin, problemet dhe kufizimet e hasura, nëse ka, masa përmirësuese të marra dhe çfarëdo informacioni tjetër i rëndësishëm.

ii) Një kopje të pasqyrave financiare të kontrolluara nga auditues të jashtëm të Bankës, brenda 6 (gjashtë) muajve pas përfundimit të çdo viti financiar të Bankës.



iii) një raport financiar përfundimtar brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e llogarisë; dhe

iv) një raport përfundimtar brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i çdo Aktiviteti që përshkruan rezultatin e Aktivitetit të financuar me Burime.

Neni 16

Detyrimi

Banka nuk do të ketë detyrime të tjera ndaj Ministrisë apo dhe Ministrisë së Financave, përveç menaxhimit dhe administrimit të Burimeve, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

V – HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin që Banka do të marrë njoftim me shkrim nga Republika e Shqipërisë, e cila konfirmon se të gjitha procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi janë përfunduar.

Neni 18

Përfundimi

18.1 Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e zbatimit ose ndërprerjes nga Banka, Lehtësimet e Burimeve janë shfrytëzuar plotësisht, cilado që ndodh më herët, nëse nuk prishet nga secila prej Palëve me paraqitjen e njoftimit me shkrim gjashtëmujor të Pala tjetër, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni 18 si më poshtë.

18.2 Pas marrjes së njoftimit të përfundimit nga secila palë në përputhje me paragrafin 18.1 më sipër, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Banka do të ndërpresë menjëherë të gjitha aktivitetet që lidhen me Burimet, përveç atyre të rastësishme për realizimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre Burimeve dhe shlyerjen e detyrimeve të drejtpërdrejta ose të kushtëzuara nga të cilat mund të varen këto burime;

b) Çdo marrëveshje tashmë e lidhur ndërmjet Bankës dhe një pale të tretë me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, nuk duhet të ndikohet nga njoftimi për ndërprerjen dhe Banka ka të drejtë të vazhdojë tërheqje nga llogaria në lidhje me marrëveshje të tilla deri në përfundimin e tyre;

c) Nëse nuk është rënë dakord ndërmjet palëve, shumica e mbetur në Llogari pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve (përfshirë taksën administrative borxh për Bankën) do t'i kthehen Ministrisë. Një kthim i tillë do t'i nënshtrohet zgjidhjes paraprake të të gjitha pretendimeve dhe ankesave nga ana e Bankës ndaj Ministrisë në lidhje me këtë Marrëveshje; dhe

d) Përveç siç është përcaktuar në këtë nen 18.2 të Marrëveshjes, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Palëve në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të pacenuara deri në kthimin e shumës sipas nenit 18.2(c) për Ministrinë dhe përmbushjen e kërkesave të raportimit sipas nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje, dhe në këtë kohë kjo Marrëveshje përfundon.

18.3 Nenet 18.2(c) dhe 18.2(d) këtu më sipër do të zbatohen edhe pas përfundimit të zbatimit apo ndërprerjes nga Banka, të Lehtësimit.

18.4 Nenet 16, 21 dhe 22 të kësaj Marrëveshjeje do të jenë të vlefshme deri në përfundim të saj.

VI – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19

Ndryshimet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim nga Palët Nënshkruese.

Neni 20

Përparësitë

Në rast të ndonjë mospërputhjeje apo kundërshtimi ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe aneksit I, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

Neni 21

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Nëse lindin mosmarrëveshje midis Palëve në lidhje me çfarëdo çështje që lind nga ose për këtë Marrëveshje, dhe kjo mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve ndërmjet Palëve, mosmarrëveshje të tilla do të zgjidhen ndërmjet Presidentit të Bankës dhe Governorit të Republikës së Shqipërisë për Bankën.

Neni 22

Të drejtat, Imunitetet dhe Përjashtimet

Asgjë në këtë Marrëveshje, që do të çmohet heqje dorë, e shprehur apo e nënkuptuar, nga



privilegjet, imunitetet dhe përjashtimet që gëzon (ka) Banka, Guvernatorët e saj, Drejtorët, Zëvendësit, Nëpunësit, Punonjësit apo Ekspertët që kryejnë misione për Bankën.

Neni 23

Komunikimet

Çdo njoftim dhe komunikim i dhënë ose i kryer sipas kësaj Marrëveshjeje për të dyja palët do të jetë me shkrim dhe do të dërgohet në adresën dhe numrin e faksit në vijim (v nëse një Palë nuk mund t'ia ketë specifikuar ndryshe me shkrim Palës tjetër):

Për Ministrinë:

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, k.p. 1001

Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Sekretarit të Përgjithshëm

Tel: 00355 4 22 27 916

Për Ministrinë e Financave:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Sekretarit të Përgjithshëm

Tel: +355 4 223 0803

Faks: +355 4 222 8405

Për Bankën:

Banka për Rindërtimin dhe Zhvillimin

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom

Në vëmendje të: Drejtorit, Bashkëfinancim i Donatorëve

Tel: +44 20 7338 7266

Faks: +44 20 7338 6538

Në dëshmi të kësaj, Banka, Ministria dhe Ministria e Financave, secila duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze, në 3 (tre) kopje origjinale në secilën gjuhë.

Për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Emri:

Pozicioni:

Data:

Për Ministrinë e Financave:

Emri:

Pozicioni:

Data:

Për Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Emri: Camilla Otto

Pozicioni: Drejtor, Bashkëfinancim i Donatorëve

Data: Data:

ANEKSI I

I. Përshkrimi i Lehtësimit

Lehtësimi për Mbështetjen e Agrobiznesit Shqiptar (Lehtësimi) është një kuadër financimi i hartuar nga BERZH-i në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, i cili synon të përmirësojë aksesin për financim për agrobiznesin shqiptar nëpërmjet bankave komerciale dhe institucioneve jobankare mikrofinanciare (bashkërisht të referuara si “Institucionet Financiare Pjesëmarrëse” ose “IFP”). Të gjitha IFP-të që operojnë në Shqipëri kanë të drejtë për t'u bashkuar me Shërbimin e Lehtësimit në bazë të respektimit të standardeve kreditore dhe integritetit të BERZH-it.

Ritmi i PFI-ve së bashku me Lehtësimin do të varet, ndër të tjera, nga disponueshmëria e fondeve të bashkëpunimit të vëna në dispozicion nga Ministria për Bankën, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, në çdo kohë të caktuar.

BERZH-i parashikon vënien në dispozicion deri në 100 milionë euro për fazën e parë të Lehtësimit, me mundësinë për të vënë në dispozicion shumat shtesë të vlefshme në të ardhmen në bazë të ecurisë së zbatimit. Lehtësimi do të përbëhet nga:

1. “Linja Kredie për Agrobiznesin”, linja kredie të pasiguruarra të nivelit të lartë për Institucionet Financiare Pjesëmarrëse (IFP-të) për huadhënie ndaj subjekteve të agrobiznesit për investime afatmesme dhe afatgjata. IFP-të do të kenë mundësi të marrin hua në monedhën vendase.



Linjat e kredisë pritet të kenë një kohëzgjatje prej 5 vjetësh.

2. “Lehtësimi i Agrobiznesit për Ndarjen e Riskut”, një pjesëmarrje e pafinancuar në një portofol bazuar në instrumentin e ndarjes së riskut që mbulon deri në 50% të shumës totale të një portofoli të kredive të papaguara të pranueshme të agrobiznesit, në përputhje me një grup të paracaktuar të kriterëve të kualifikimit (përshtatshmërisë) (Riskedulim Kredie). Sipas kësaj strukture, Riskedulimi i Kredisë do të gjenerohet, vlerësohet, miratohet, disbursohet dhe monitorohet nga çdo IFP, në përputhje me politikat e tyre të kreditimit. Përmes Lehtësimit, BERZH-i do të mbulojë deri në 50% të riskut të portofolit të Riskedulimit të Kredisë, duke ndarë mbi baza proporcionale me IFP për çdo humbje të shkaktuar nga një portofol i tillë, si dhe çdo rikuperim të mundshëm me 50% të mbetur të një rreziku të tillë plotësues të portofolit, duke u absorbuar nga Riskedulimi i Kredisë së paracaktuar.

Çdo Lehtësim për ndarje të riskut për agrobiznesin do të jetë një strukturë e hapur që do të fillojë me një gjendje/stok deri në 50% të portofolit të kredisë ekzistuese të agrobiznesit të një IFP-je të caktuar që përputhet me kriteret e përshtatshmërisë së (Gjendja fillestare). IFP-të do të angazhohen për të sjellë kriteret e reja të lejueshme të Riskedulimit të Kredive për sektorin e agrobiznesit në total të paktën 2 herë shumën e Gjendjes fillestare (një portofol maksimal që do të gjenerohet, mund të bihet dakord me IFP-në rast pas rasti) për një periudhë 3-vjeçare nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes Riskut ndërmjet BERZH-së dhe IFP-së.

Pas këtyre 3 viteve të krijimit të portofolit, sistemi do të mbyllet dhe BERZH-i do të vazhdojë të mbulojë pjesën e saj të portofolit të konsiderueshëm (papaguar) të Riskedulimit të Kredisë, derisa ato të jenë shlyer plotësisht ose fshirë, deri në një datë të përfundimit të rënë dakord që nuk duhet të kalojë 5 vjet nga mbyllja e sistemit. Kjo strukturë do të mundësojë IFP-në për të rritur portofolin e tyre të kredisë për sektorin e agrobiznesit për të paktën 200% (ose më shumë) të nivelit aktual deri në kohën e mbylljes së sistemit (d.m.th. në 3 vjet).

Për këtë pritet që zbatimi i Lehtësimit në çdo IFP do të marrë 8 vjet, ndërsa kohëzgjatja e pritshme e të gjithë Lehtësimit në mbarë vendin do

të jetë më e gjatë, rreth 9-10 vjet në varësi nga data kur IFP-ja e fundit do t'i bashkohet Lehtësimit.

Këta dy komponentë – Linja kredie për Agrobiznesin dhe Lehtësimi për Ndarjen e Riskut të Agrobiznesit - janë plotësues dhe mund të vihen në dispozicion veçmas ose bashkërisht për çdo IFP, në varësi të preferencave të tyre. Bazuar në vlerësimet paraprake në konsultimet me disa IFP potenciale, është vlerësuar se shumica e përgjithshme e Riskedulimit të Kredisë të Portofolit të mobilizohet nëpërmjet Lehtësimit në fazën e parë, e cila do të jetë rreth 180 milionë euro (shuma e saktë do të varet nga përqindja e agrobiznesit të Linjave të Kredive për Agrobiznesin ndaj Lehtësimit për ndarjen e Riskut të Agrobiznesit për të cilat këto IFP do të abonohen).

- Lehtësimi do të përfitojë nga dy komponentë shtesë:

- Mbulimi i Riskut për Humbjen e Parë (FLRC) mbulon:

- në rastin e Linjave të Kredisë të Agrobiznesit – humbjet deri në 20% të shumës totale të Kredive të riskeduluara të financuara me vazhdimin e Linjave të Kredisë të Agrobiznesit;

- në rastin e Lehtësimit për Ndarjen e Riskut të Agrobiznesit - humbjet deri në 20% të portofolit të Riskedulimit të Kredive të pranueshme ndahen midis BERZH-it dhe PFI-së. Çdo humbje shtesë nga Riskedulimi i Kredive të papaguara që tejkalon mbulimin e FLRC-së do të ndahet *pari-passu* (në mënyrë të barabartë) midis BERZH-it dhe IFP-së.

Fondet për FLRC-në do të sigurohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje. Pritet që ajo do të ndihmojë në mënyrë të konsiderueshme për të përmirësuar aksesin për financim për huamarrësit e agrobiznesit duke ulur koston e rrezikut për IFP-të, nxitjes së tyre për të zgjeruar huadhënien për sektorin e agrobiznesit dhe nëpërmjet konkurrencës midis IFP-ve, të çojë në norma më të përballueshme të kreditimit për huamarrësit përfundimtarë.

Asistenca Teknike (AT), e cila do të përbëhet nga dy komponentë:

A. Sektori i Agrobiznesit – AT specifike:

i) Vlerësimi i problemeve të mundshme të sektorit që pengojnë aksesin për financim përmes analizës së portofolit ekzistues të IFP-së së

agrobiznesit dhe klientëve të rinj të synuar të agrobiznesit. Analiza të tilla mund të ndihmojnë, gjithashtu, për të identifikuar pikat përkatëse hyrëse për dialog të mundshëm politik me Qeverinë në çështjet strukturore specifike të sektorit, duke garantuar përputhshmërinë dhe sinergjitë e mundshme ndërmjet Lehtësimit të propozuar dhe vazhdimësisë së aktiviteteve specifike të sektorit, të mbështetura nga donatorë të tjerë.

ii) Shërbimi këshillimor ndaj huamarrësve të IFP-ve dhe huamarrësve potencialë do të sigurohet nga BERZH-i - grupi Mbështetja e Biznesit të Vogël (SBS). Mbështetja këshilluese e SBS-së për agrobizneset synon të lehtësojë aksesin për njohuritë dhe hartimin e shërbimeve jofinanciare, duke mbështetur SME-të e lejueshme në zonat që rrjedhin nga strategjitë, veprimet e menaxhimit të cilësisë, specifike për sektorin e agrobiznesit. Gjithashtu, vlerësimi i mësipërm do të ndihmojë për identifikimin e nevojave për hartimin e shërbimeve shtesë jofinanciare, specifike për sektorin e agrobiznesit.


iii) Forcimi potencial i organizatave të prodhuesve vendas, ku Banka mund të transferojë njohuritë dhe përvojën e saj nga puna me shoqatat e industrisë në vendet e tjera nën Sektorin Privat të Agrobiznesit për iniciativat e Sigurisë Ushqimore.

B) Ngritja e kapaciteteve të IFP-së:

i) përshtatshmëria dhe synimi në mbështetje për IFP-të, duke përfshirë ndër të tjera: zhvillimin e produkteve të reja ose përmirësimin e produkteve ekzistuese të agrobiznesit, përmirësimin e politikave dhe procedurave për kreditimin e agrobiznesit, trajnimin e stafit, ndryshimet e mundshme operative/organizative, përpunimin, sistemet e monitorimit dhe raportimit, si dhe mbështetjen e zbatimit të programit të përgjithshëm;

ii) rritja e ndërgjegjësimit (vetëdijes) përmes seminareve, sesioneve të veçanta të sektorit të agrobiznesit në formën e eventeve të marketingut për IFP-të.

Skema e mëposhtme paraqet strukturën e Lehtësimit.



II. Qeverisja

Komiteti Drejtues do të krijohet për të monitoruar zbatimin e Aktivitetit (siç është përcaktuar në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje). Ai do të përbëhet nga përfaqësues të kualifikuar nga Ministria dhe BERZH-i dhe do të mblidhet çdo vit, zakonisht një muaj pas marrjes së raportit vjetor të progresit. Puna e Komitetit Drejtues do të jetë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe rregullat, politikat dhe procedurat përkatëse të Bankës. Në rastet kur puna e Komitetit Drejtues kërkon që Banka të sigurojë ndonjë informacion, ky informacion do të sigurohet mbi baza të shëndosha dhe në përputhje me Politikën e Bankës për Informimin Publik.

Roli i Komitetit Drejtues do të jetë:

- a) të shqyrtojë raportin vjetor të progresit për zbatimin e veprimtarisë;
- b) të marrë parasysh përvojat e fituara gjatë zbatimit të Aktivitetit, me qëllim propozimin për përmirësim;
- c) të shqyrtojë arritjet e institucionit në kontekstin e objektivave zhvillimorë të Qeverisë së Shqipërisë për sektorin e agrobiznesit në periudhën e caktuar;
- d) të diskutojë dhe të bjerë dakord mbi planin e transparencës për të promovuar Aktivitetin;
- e) të rishikojë, kur të jetë e nevojshme, publikimet, të cilat raportojnë mbi Aktivitetin.

III. Transparenca

Aktivitetet e transparencës do të garantojnë shpërndarjen e informacionit në lidhje me objektivat dhe arritjet e Aktivitetit. Aktivitetet që do të ndërmerren do të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Hapjen e programit/mbylljen e eventit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Qeverisë shqiptare;
- Marrëdhëniet me median (intervista në Revista lokale të biznesit/gazeta);
- Evente të veçanta (p.sh., seminarët e ndërgjegjësimit);
- Studimet e rasteve (p.sh., artikuj që paraqesin histori suksesi për shtypin);
- Internet dhe gjuhën lokale (përmbajtja në rrjetin e Internetit);
- Kontributet ndaj mediave sociale.

LIGJ

Nr. 6/2016

**PËR RATIFIKIMIN E
MARRËVESHJES PËR THEMELIMIN E
FONDIT TË BALLKANIT
PERËNDIMOR DHE STATUTIT TË TIJ**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe statutit të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.2.2016

Shpallur me dekretin nr. 9421, datë 11.2.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

**PËR THEMELIMIN E FONDIT TË
BALLKANIT PERËNDIMOR**

Qeveritë e Republikës së Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës*, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë (referuar në vijim si “Palë Kontraktuese”);

Të udhëhequra nga dispozitat e Deklaratës së Përbashkët të Ballkanit Perëndimor, të nënshkruar më 31 tetor 2014, në Bratislavë,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Themelohet Fondi i Ballkanit Perëndimor (referuar në vijim si “Fondi”), me seli në Tiranë.

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e KS-së të OKB-së nr. 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Neni 2

Miratohet Statuti i Fondit dhe përbën një aneks të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Kjo Marrëveshje dhe aneksi i tij mund të amendohen me shkrim, me miratim të Palëve Kontraktuese.

Neni 4

1. Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim nga Palët Kontraktuese.

2. Kjo Marrëveshje miratohet në zbatim të legjislacionit përkatës të secilës Palë Kontraktuese dhe hyn në fuqi në ditën kur instrumenti i fundit, që vërteton miratimin, depozitohet te Qeveria e Republikës së Shqipërisë që vepron si Depozitues.

Neni 5

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e cila vepron si Depozituese, njofton të gjitha Palët Kontraktuese mbi depozitimin e të gjitha instrumenteve që vërtetojnë miratimin, hyrjen në fuqi të saj, si dhe mbi çdo fakt tjetër që lidhet me këtë Marrëveshje.

Neni 6

1. Secila Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje në çdo kohë, duke i dërguar një njoftim me shkrim Depozituesit, i cili, më pas, i dërgon secilës Palë Kontraktuese një kopje të vërtetuar të njoftimit.

2. Tërheqja hyn në fuqi gjashtë muaj nga data kur njoftimi është marrë nga Depozituesi.

3. Shpërndarja e Fondit, në përputhje me Statutin e Fondit, përbën zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje dhe marrëdhënieve të saj me Palët e tjera Kontraktuese.

Neni 7

1. Qeveria e Shqipërisë vepron si Depozituese e kësaj Marrëveshjeje.

2. Originali i kësaj Marrëveshjeje, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, depozitohet te Depozituesi, i cili i dërgon secilës Palë Kontraktuese një kopje të vërtetuar.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar si duhet nga Qeveritë përkatëse, nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Bërë në Pragë, në datën e trembëdhjetë të nëntorit, dy mijë e pesëmbëdhjetë, në një original të vetëm në gjuhën angleze.

Republika e Shqipërisë:

Bosnjë dhe Hercegovina:

Kosova*:

Republika e Maqedonisë:

Mali i Zi:

Republika e Serbisë:

ANEKSI I

STATUTI I FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR

KAPITULLI NJË

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Neni 1

Qëllimi i Fondit është të promovojë:

- zhvillimin e një bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet Palëve Kontraktuese;
- forcimin e lidhjeve ndërmjet Palëve Kontraktuese;
- integrimin e Palëve Kontraktuese në Bashkimin Evropian;
- prezantimin e përbashkët të Palëve Kontraktuese në vende të treta.

Neni 2

Objektivat e Fondit ndiqen nëpërmjet mbështetjes financiare të aktiviteteve në çdo fushë që kontribuon për bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërrajonal dhe për forcimin e kohezionit rajonal, në veçanti në fushat e mëposhtme:

- nxitja dhe zhvillimi i bashkëpunimit kulturor;
- nxitja dhe zhvillimi i shkëmbimeve shkencore, kërkimit dhe bashkëpunimit në fushën e arsimit ndërmjet Palëve Kontraktuese;
- nxitja dhe zhvillimi i shkëmbimeve ndërmjet të rinjve;
- nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të Palëve Kontraktuese.

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese në këto fusha, i rregulluar sipas traktateve të tjera ndërkombëtare, nuk do të ndikohet nga kjo Marrëveshje.

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e KS-së të OKB-së nr. 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Neni 3

Fondi mund të mbështesë projekte që e kanë origjinën nga vende të tjera, përveç Palëve Kontraktuese, me kusht që të kenë të paktën 2 (dy) partnerë bashkorganizues nga Palët Kontraktuese dhe që tema e projekteve të lidhet me rajonin e Ballkanit Perëndimor.

KAPITULLI DY
SELIA DHE ANËTARËSIA

Neni 4

Palët Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje janë Themeluesit e Fondit. Selia e Fondit është në Tiranë, Republika e Shqipërisë.

KAPITULLI TRE
STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 5

Organet qeverisëse të Fondit, janë:

- Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme;
- Këshilli i Zyrtarëve të Lartë;
- Drejtori Ekzekutiv;
- Sekretariati.

Neni 6

Fondi ka dhe përdor, siç mund ta kërkojë rasti, një Vulë që ka një pajisje ose stampë me mbishkrimin “Fond i Ballkanit Perëndimor”. Vula e Fondit mbahet nën administrimin e Drejtorit Ekzekutiv.

KAPITULLI KATËR
KONFERENCA E MINISTRAVE TË
PUNËVE TË JASHTME

Neni 7

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme është organi më i lartë i Fondit.

Neni 8

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme përbëhet nga Ministrat e Punëve të Jashtme të Palëve Kontraktuese ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar sipas rregullave.

Neni 9

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme cakton nga anëtarët e vet Kryetarin e saj, me Kryesinë e Radhës që qarkullon në rend alfabetik në gjuhën angleze të emrave të Palëve Kontraktuese.

Neni 10

Mandati i Kryetarit të Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme është njëvjeçar dhe i parapërsëritshëm.

Neni 11

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme miraton çdo vit Buxhetin e Fondit, pasqyrat vjetore të Palëve Kontraktuese dhe pagimin e buxhetit të paraqitur nga Këshilli i Zyrtarëve të Lartë.

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme cakton kontributet vjetore të Palëve Kontraktuese dhe datat e pagesës së tyre.

Neni 12

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme miraton planet vjetore dhe afatgjata në lidhje me aktivitetet e Fondit.

Neni 13

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme miraton kërkesat për Anëtarësim në FBP dhe pranimin e tyre në FBP.

Neni 14

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme pranon/miraton Rregullat e Procedurës së Sekretariatit dhe mund të vendosë për ndryshimet e tyre.

Neni 15

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme miraton rezolutat me konsensus.

Neni 16

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme takohet, të paktën një herë në vit. Kryetari i Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme planifikon vendin dhe datën e sesionit të saj.



KAPITULLI PESË KËSHILLI I ZYRTARËVE TË LARTË

Neni 17

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë përbëhet nga Zyrtarë të Lartë nga Ministrinë e Punëve të Jashtme të Palës Kontraktuese ose përfaqësues të tjerë të emëruar sipas rregullave.

Neni 18

Sesionet e Këshillit të Zyrtarëve të Lartë kryesohen nga i plotfuqishmi i Palës Kontraktuese, përfaqësuesi i së cilës mban postin e Kryetarit të Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 19

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë përgatit programet e aktiviteteve të Fondit dhe raporton për zbatimin e tyre në vitin pararendës dhe i paraqet për miratim në Konferencën e Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 20

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë përgatit projekt-buxhetet e Fondit dhe raporton për shfrytëzimin e tyre në vitin pararendës dhe i paraqet për miratim në Konferencën e Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 21

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë përcakton udhëzimet detyruese për aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv dhe rregullat që drejtojnë përgatitjen, pranimin dhe zbatimin e projekteve të paraqitura te Fondi, duke marrë në konsideratë rregullat që administrojnë të drejtat dhe detyrat e Drejtorit Ekzekutiv, të përcaktuara nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 22

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë harton programet dhe dokumentet për sesionet e Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 23

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë i miraton vendimet me konsensus.

Neni 24

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë takohet të paktën një herë çdo gjashtë muaj dhe midis këtyre

periudhave, sa herë që e çmon të përshtatshme, për realizimin e objektivave të përcaktuar në kapitullin një. Kryetari i Këshillit të Zyrtarëve të Lartë planifikon vendin dhe datën e sesioneve të tij.

Neni 25

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë miraton Rregullat e veta të Procedurës që do t'i nënshtrohen miratimit nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 26

Këshilli i Zyrtarëve të Lartë mund t'i propozojë Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme ndryshime në Rregullat e Procedurës së Sekretariatit, të cilat duhet të miratohen në bazë të nenit 14.

KAPITULLI GJASHTË DREJTORI EKZEKUTIV, NËNDREJTORI EKZEKUTIV DHE SEKRETARIATI

Neni 27

Drejtori Ekzekutiv do të shërbejë si funksionari drejtues ekzekutiv i Fondit dhe përfaqëson Fondin. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e objektivave të Fondit dhe të performancës së efektshme të tij.

Drejtori Ekzekutiv do të ngarkohet të përfaqësojë Fondin dhe interesat e tij, dhe të bëjë përfaqësime në emër të Fondit. Në emër të Fondit, Drejtori Ekzekutiv do të ngarkohet nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme të nënshkruajë Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe marrëveshje të tjera përkatëse për funksionimin e fondit.

Drejtori Ekzekutiv drejton Sekretariatin.

Drejtori Ekzekutiv drejton të gjitha përpjekjet për mbledhjen e fondeve, në emër të Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Drejtori Ekzekutiv përgatit raportet dhe buxhetin për organizmat përkatës të vendim-marrjes.

Drejtori Ekzekutiv koordinon procesin e thirrjes për propozime, vlerësimet për projekt-propozimet dhe përgatit rekomandimet për veprimet e granteve të Zyrtarët e Lartë të Këshillit për vendim.

Drejtori Ekzekutiv koordinon monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të realizuara.



Drejtori Ekzekutiv udhëton shpesh në rajon për të kontaktuar Palët e interesuara dhe merr pjesë në evente lidhur me aktivitetet e Fondit.

Drejtori Ekzekutiv përgatit dhe koordinon komunikimin e Fondit.

Neni 28

Secila Palë Kontraktuese ka të drejtë të caktojë kandidatin e saj për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv dhe Nëndrejtorit Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv dhe Nëndrejtori Ekzekutiv caktohen nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme me konsensus. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv dhe të Nëndrejtorit Ekzekutiv është tre vjet dhe i parapërsëritshëm, përveç rasteve kur, nëse vendoset ndryshe nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 29

Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme përcakton rregullat lidhur me të drejtat dhe detyrat e Drejtorit Ekzekutiv dhe të Nëndrejtorit Ekzekutiv, mënyrën se si duhet të kryhen si mandatet e Drejtorit Ekzekutiv dhe të Nëndrejtorit Ekzekutiv.

Neni 30

Drejtori Ekzekutiv merr pjesë në sesionet e Konferencës së Ministrave të Këshillit të Zyrtarëve të Lartë në cilësinë e këshilltarit.

Neni 31

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për funksionimin e Sekretariatit dhe në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese në territorin ku Fondi ka selinë përcakton afatet dhe kushtet e punësimit për afatin e Sekretariatit, në zbatim të rregullave të miratuara nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 32

Drejtori Ekzekutiv informon rregullisht Kryetarin e Këshillit të Zyrtarëve të Lartë mbi mënyrën e zbatimit të programit të veprimtarive të Fondit, përgatit pasqyrat vjetore dhe pagimin e buxhetit të Fondit.

Neni 33

Sekretariati është përgjegjës për shërbimet që sigurohen gjatë sesioneve të Këshillit të Zyrtarëve

të Lartë dhe shërbimet që jepen në lidhje me sesionet e Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme, si dhe shërbimet e tjera lidhur me funksionimin e Fondit.

Neni 34

Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv janë të karakterit ndërkombëtar. Në kryerjen e detyrave të tij/saj, Drejtori Ekzekutiv zbaton rregullat e përcaktuara nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme dhe nuk merr udhëzime nga palët e treta.

Në kryerjen e detyrave të tyre, Drejtori Ekzekutiv dhe Stafit i Sekretariatit të FBP-së nuk kërkojnë, marrin apo veprojnë mbi bazën e udhëzimeve të ndonjë qeverie apo ndonjë autoriteti tjetër jashtë Fondit.

Secila Palë Kontraktuese merr përsipër të respektojë karakterin ndërkombëtar ekskluziv të përgjegjësisë të Drejtorit Ekzekutiv dhe Stafit i Sekretariatit nuk kërkon të ndikojë tek ato për shkarkimin e përgjegjësisë të tyre.

Neni 35

1. Stafit i FBP-së përbëhet nga persona, të cilët punojnë nën autoritetin e Drejtorit Ekzekutiv dhe të Nëndrejtorit Ekzekutiv.

2. Stafit i FBP-së përbëhet nga shtetas të Pjesëmarrësve, duke marrë parasysh përfaqësimin e duhur të të gjitha Palëve Kontraktuese.

3. Rregulloret e Stafit përfshijnë rregullat, parimet dhe procedurat që rregullojnë përzgjedhjen e stafit, rekrutimin e tyre, klasifikimin e posteve, si dhe funksionimin e efektshëm të Sekretariatit të FBP-së për arritjen e objektivit të këtij Statuti.

Neni 36

Gjuha zyrtare e Fondit është anglishtja.

KAPITULLI SHITATË STATUSI LIGJOR I FONDIT

Neni 37

Fondi ka personalitetin e plotë ligjor të nevojshëm për përmbushjen e qëllimeve lidhur me aktivitetet e tij.

KAPITULLI TETË
FINANCAT

Neni 38

Aktivitetet e Fondit financohen nga kontributet e Palëve Kontraktuese, si dhe nga kontribute financiare nga burimet e tjera të miratuara nga Këshilli i Zyrtarëve të Lartë.

Neni 39

Secila Palë Kontraktuese merr përsipër të sigurojë një kontribut vjetor për Fondin, brenda tremujorit të parë të secilit vit. Kontributi vjetor për Fondin është 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro). Shuma e kontributit vjetor mund të ndryshojë me vendim të Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 40

Rregullat që rregullojnë përdorimin e mjeteve financiare të Fondit përcaktohen nga Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme.

Neni 41

Fondi hap llogarinë e tij bankare te Pala Kontraktuese, duke siguruar selinë e Fondit. Burimet financiare të Fondit ruhen në këtë llogari bankare. Fondet administrohen nga Drejtori Ekzekutiv.

KAPITULLI NËNTË
SHPËRNDARJA E FONDIT

Neni 42

Kur secili Pjesëmarrës i Fondit të Ballkanit Perëndimor merr vendimin për t'u tërhequr nga Fondi i Ballkanit Perëndimor, sipas nenit 6 të Marrëveshjes mbi themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, Drejtori Ekzekutiv ndërpret menjëherë çdo aktivitet dhe të gjitha aktivitetet me përjashtim të atyre që lidhen me mbledhjen dhe likuidimin e kërkuar të aseteve dhe kryerjen e pagesave të detyrimeve.

Neni 43

Brenda disbursimit të aseteve, detyrimet e Fondit kanë prioritet mbi kompensimin e kontributeve.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi lekë